

## KËRKESË PËR OFERTË PËR OFRUES TË TRAJNIMEVE PROFESIONALE

### *Procedura për kuotimin e çmimeve*

<b>Numri kërkesës për ofertim:</b>	ICK-CLF-2020/019
<b>Data e publikimit</b>	25.02.2020
<b>Data e mbylljes:</b>	05.03.2020
<b>Titulli i kontratës:</b>	RISHPALLJE - Trajnim Profesional në React JS
<b>Autoriteti Kontraktues</b>	Innovation Centre Kosovo, ICK
<b>Adresa:</b>	Rr. Rexhep Mala 28A, 10000 Prishtinë, RKS
<b>E-mail:</b>	info@ickosovo.com

### PËRMBLEDHJE

Innovation Centre Kosovo (ICK) fton subjektet/individët e interesuar/a të paraqesin ofertat për:

#### - **RISHPALLJE - Trajnim Profesional në React JS**

Qëllimi i kësaj ftese për ofertim është të identifikojë ofruesit e kualifikuar për trajnimin e kërkuar. Ofertuesit e interesuar duhet të kenë kapacitet për të zhvilluar dhe ofruar trajnime në klasë duke përfshirë materialet, prezantimet, ushtrimet praktike, studimet e rasteve dhe diskutimet në grup. Kompanitë/Ligjëruesit Profesional duhet të ofertojnë sipas kërkesës të paraqitur në këtë dokument.

### KUSHTET E DETYRUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha Kompanitë/Ligjëruesit Profesional të interesuar/a duhet të dorëzojnë ofertën e tyre siç parashihet më poshtë.

Ofertat duhen të shënojnë / ofrojnë informacionin e mëposhtëm shtesë:

- Duhet të shënohet numri i ftesës për ofertim,
- Duhet të shënohet data e ofertës,
- Programin, metodologjinë, kurrikulën e detajuar të trajnimit / trajnimeve si dhe numrin e orëve (një orë e trajnimit = 60 minuta),
- Duhet të ofrohet vlefshmëria e ofertës. (Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku 60 ditë),
- Për kompanitë duhet të ofrohen dokumentet zyrtare të kompanisë në vijim: Çertifikata e regjistrimit të biznesit, Informatat për biznesin, çertifikata fiskale dhe çertifikata e TVSH-së ( të gjitha në kopje) si dhe licenca nga organet kompetente për kryerjen e punëve (nëse është e aplikueshme) ,
- Për konsulentët duhet të ofrohet: Kopja e Letënjoftimit dhe Licenca nga organet kompetente për kryerjen e punëve (nëse është e aplikueshme),
- Oferta financiare duhet të jetë në Euro dhe te ceket cmimi për orë 60 minuta (me te gjitha taksat),
- Në rast se TVSH-ja nuk është përcaktuar, ICK-ja do të konsiderojë se çmimi përfshinë TVSH-në,
- Duhet të ofrohen referencat mbi shërbime të ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (minimum 3 referenca) si dhe CV-të e Ligjëruesit/ve Profesional që do të mbajë trajnimin,
- Ofertat mund të përgatiten në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare në Kosovë apo në gjuhë angleze,
- Oferta duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur në Zyret e ICK-së, Rruga Rexhep Mala 28A, 10000 Prishtinë. Afati i fundit i dorëzimit të ofertës është 05.03.2020, ora 12:00.

**\*SHËNIM ME RËNDËSI:**

- i) Mosplotësimi i ndonjërit prej kushteve të detyrueshme për pjesëmarrje ju diskualifikon nga pjesëmarrja e mëtejme në vlerësim të Ofertës suaj.
- ii) Me rastin e nënshkrimit të kontratës, kompania/konsulenti/ja fituese duhet të prezentoj vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës që nuk ka borxhe, jo më të vjetër se 90 ditë.
- iii) Çdo palë e interesuar mund të bejë ankesë pranë autoritetit kontraktues brenda afatit 7 (shtatë) ditë nga data e njoftimit.

**KUSHTET DHE RREGULLAT E KUOTIMIT**

- Oferta duhet të dorëzohet në Zyret e ICK-së.
- Afati i fundit i dorëzimit të ofertës është 05 Mars 2020, ora 12:00.
- Për çdo pyetje, mund të dërgoni kërkesë me shkrim përmes email-it në këtë adresë: [info@ickosovo.com](mailto:info@ickosovo.com). Pyetjet pranohen der mëi 02 Mars 2020.
- Hapja e ofertave do të bëhet me 05 Mars 2020 ora 14:30 nga Komisioni përzgjedhës (i përbërë nga 3 anëtarë) dhe të gjitha palët e interesuara kanë të drejtë të jenë prezent.
- Me rastin e hapjes së ofertave dhe në rast që shtrohet nevoja, Komisioni Vlerësues ka të drejtë të bëjë pyetje shtesë ndaj ofertuesve. Pyetjet do të komunikohen tek të gjitha palët.
- Ofertat do të vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme kualitative dhe kuantitative.

KRITERET	%
<b>1. Kriteret Kualitative</b>	
1.1. Programi, metodologjia dhe kurrikula propozuar	40%
1.2. Përgaditja, historiku dhe përvoja e Ligjëruesit/ve të propozuar	10%
1.3. Referenca me detaje të kontaktit (minimum 3 referenca)	10%
<b>2. Kriteret Financiare</b>	
2.1. Ofertë ekonomikisht më e favorshme	40%
<b>Total:</b>	<b>100%</b>